



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

P R O J E K T L I G J

Nr. ____/2018

PËR

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.124/2015,
“PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË”

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.124/2015, “Për efiçencën e energjisë” bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Pika 2, e nenit 4, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Auditues energjetik” është një person fizik ose juridik, që kryen auditime energjetike, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, dhe që ka të regjistruar në regjistrin tregtar, si objekt veprimtarie, kryerjen e kësaj veprimtarie.”.

Neni 2

Pika 1, e nenit 16, ndryshohet, si më poshtë vijon:

- “1. Auditimet energjetike kryhen nga auditues energjetikë të certifikuar ose nga persona juridikë, që kanë të punësuar auditues energjetikë të certifikuar, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.”.

Neni 3

Neni 17 ndryshohet, si më poshtë vijon:

- “1. Audituesi energjetik është një person fizik i certifikuar ose person juridik, që ka të punësuar auditues energjetikë të certifikuar.
2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, miraton kategoritë, kushtet, kërkesat e kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni.
3. Audituesi energjetik detyrohet të regjistrojë në regjistrin tregtar, si objekt veprimtarie, kryerjen e veprimtarisë së audituesit energjetik.
4. Audituesi energjetik, për ushtrimin e kësaj veprimtarie, është i detyruar që, para fillimit të këtij aktiviteti, të njoftojë Agjencinë për Efiçencën e Energjisë.
5. Agjencia për Efiçencën e Energjisë mban regjistrin kombëtar për personat fizikë dhe juridikë, të cilët ushtrojnë aktivitet si auditues energjetikë.
6. Auditimi energjetik nuk kryhet nga një auditues energjetik, i cili:
 - a) zotëron aksione ose kuota në një shoqëri, që ka kërkuar të auditohet, ose së cilës i bëhet auditimi;
 - b) është anëtar i një organi drejtues të entitetit, që ka kërkuar, ose të cilit i bëhet auditimi, ose është i punësuar nga personi që ka kërkuar auditimin;
 - c) është i afërm i shkallës së dytë i personit, që, për shkak të pozitës së tij në personin e audituar, mund të ndikojë mbi audituesin energjetik.
7. Audituesi energjetik mban konfidenciale të gjitha të dhënat lidhur me personin fizik ose juridik, të përftuara në kuadrin e auditimit të kryer në objektet energjetike të këtij personi. Audituesi energjetik nuk duhet të përfitojë nga këto të dhëna dhe nuk duhet t'i përdorë në interes ose në dëm të subjektit të audituar apo të një pale të tretë. Detyrimi i konfidencialitetit mund të hiqet me miratimin me shkrim nga personi

fizik ose juridik, objekt i auditimit energjetik, ose nëse bërja publike e tyre parashikohet nga një ligj tjetër.

8. Ministri përgjegjës për energjinë, me iniciativën e tij ose me propozimin e Agjencisë për Efiçencën e Energjisë, pas një procedure në përputhje me legjislacionin në fuqi, që i garanton audituesit të certifikuar të drejtën për t'u njoftuar, për t'u dëgjuar dhe për t'u ankuar lidhur me shkeljen, vendos ndërprerjen e ushtrimit të këtij aktiviteti nga audituesi energjetik përkatës, në rast se:
 - a) provohet se në procesin e auditimit energjetik janë shkelur dispozitat e këtij ligji dhe kërkesat e përcaktuara në aktet nënligjore;
 - b) provohet se audituesi bën publik informacionin dhe të dhënat e shoqërisë, si dhe sekretet tregtare të konsumatorëve, me të cilat ai është njohur për shkak të auditimit, me kusht që publikimi i tyre të jetë ankimuar nga subjekti i audituar.
9. Ministri njofton me shkrim audituesin energjetik për vendimin e tij për revokimin e certifikatës, sipas pikës 8, të këtij neni.
10. Një person fizik ose juridik, të cilit i është ndërprerë e drejta e ushtrimit të kësaj veprimtarie, sipas pikës 8, të këtij neni, ka të drejtë të rifillojë ushtrimin e aktivitetit, nëse përmbush kriteret për të qenë auditues, jo më herët se një vit nga data e marrjes së vendimit të mësipërm.”.

Neni 4

Në nenin 18 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2, e këtij neni, ndryshohet, me këtë përmbajte:

“2. Shërbimet energjetike ofrohen nga subjekte, që kanë të regjistruar në regjistrin tregtar, si objekt veprimtarie, kryerjen e kësaj veprimtarie dhe në përputhje me përcaktimet e këtij ligji. Agjencia për Efiçencën e Energjisë mban, përditëson dhe publikon në faqen e saj zyrtare një listë të ofruesve të shërbimeve energjetike.”.
2. Pas pikës 5 shtohen pikat 6 e 7, si më poshtë vijon:

“6. Agjencia për Efiçencën e Energjisë mban regjistrin kombëtar për personat fizikë dhe juridikë, të cilët ushtrojnë aktivitet si ofrues të shërbimeve energjetike.

7. Ofruesi i shërbimeve energjetike, për ushtrimin e kësaj veprimtarie, është i detyruar që, para fillimit të këtij aktiviteti, të njoftojë Agjencinë për Efiçencën e Energjisë.”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI